



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# UDHËZUES PËR RIKTHIMIN NË FUSHAT E BASKETBOLLIT

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

MAJ 2020

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Hyrje

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) e ka përgatitur këtë udhëzues për të ndihmuar komunitetin e basketbollit në të gjithë Kosovën për tu rikthyer në aktivitetet e strukturuar të basketbollit. FBK ka punuar vecanërisht duke iu bazuar rekomandimeve të autoriteteve në vendin tonë. FBK ka qëndruar pranë komunitetit të basketbollit gjatë gjithë këtyre kohërave të vështira, andaj FBK falënderon të gjithë për ndihmën dhe përkushtimin e tyre ndaj zhvillimit të sportit tonë të dashur.

Këto udhëzime janë hartuar si një kornizë për të ndihmuar riaktivizimin e sportit tonë, gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e autoriteteve në vendin tonë.

### **Parimet e udhëzuesit janë:**

- Mbajtja e familjes së basketbollit të sigurtë dhe të shëndetshme;
- Respektimi i kufizimeve të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Në përputhje me Institutin e Shëndetësisë Publike të Kosovës;
- Përdorimi i udhëzimeve të caktuara nga FBK.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kritike, respektimi i udhëzuesit

Duke e përgatitur këtë Udhëzues, FBK synon që t'u sigurojë të gjithë anëtarëve të saj sqarime se cilat aktivitete mund të zhvillohen në secilën fazë të kufizimeve që janë në fuqi nga autoritetet në vendin tonë.

Do të jetë kritike për secilin klub/shkollë të basketbollit që të marrë parasysh këto udhëzime specifike të autoriteteve në vendin tonë dhe duhet të merret parasysh fakti se mund të ketë ndryshime në qytete të ndryshme varësisht se si do të zhvillohet situata me pandeminë COVID-19, por që FBK do të vazhdojë të përditësojë të gjithë anëtarët e saj.

Klubet/shkollat e basketbollit gjithashtu duhet të punojnë me palët tjera të interesit si përshembull me pronarët e objekteve jashtë, të cilët mund të kenë kërkesat e tyre në përdorimin e lehtësimeve të masave të kufizimit.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) më 30 Prill 2020 i ka publikuar hapat e përcaktuar për planifikim të kthimit në normalitet nga pandemia COVID-19, të cilët hapa janë të kushtëzuar nga përmirësimi i gjendjes epidemiologjike.

Dhe lehtësimi i këtyre masave është ndarë në tri faza, ku në të tri këto faza gjithashtu do të bëhen rivlerësime varësisht nga situata që mund të krijohet në ditët, javët e muajt në vazhdim.

Hapja selektive e aktiviteteve sportive bën pjesë në fazën e tretë, e cila është paraparë të fillojë më 1 Qershor.

FBK do ta respektoj këtë vendim të institucioneve përgjegjëse në vendin tonë, dhe të njëjtën gjë do ta kërkojë edhe nga anëtarët e saj, klubet, shkollat e basketbollit dhe shoqatat.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Rikthimi dhe implementimi i udhëzimeve

Për Federatën e Basketbollit të Kosovës prioritet është shëndeti i të gjithë njerëzve që janë pjesë e komunitetit të basketbollit e më gjerë.

Basketbolli konsiderohet si një ndër sportet me kontaktin më të madh dhe për këtë arsye FBK ka propozuar një numër masash që do të lejojnë zhvillimin e sportit të sigurt.

Nëse deri më 1 Qershor gjendja vazhdon duke u përmirësuar dhe institucionet përgjegjëse për vendin tonë vendosin të lejojnë hapjen selektive të aktiviteteve sportive, FBK bazuar në praktikën më të mira të Federatave simotra propozon udhëzimet e mëposhtme për stërvitje basketbolli, nëse realizohet në një fushë basketbolli të jashtme dhe lejohet brenda komunitet lokal:

- Para se të shkoni në çdo seancë stërvitore, lojtarët dhe trajnerët duhet të masin temperaturën e trupit në shtëpitë e tyre. Në rast të shfaqjes së ndonjë simptome të vështirësive në frymëmarrje, ju duhet të qëndroni në shtëpi;**
- Dezinfektimi i duarve të të gjithë lojtarëve/trajnerëve para, gjatë pushimeve, dhe pas stërvitjes është i obligueshëm, ndërsa dezinfektuesi duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë lojtarët që marrin pjesë në stërvitje;**
- Maksimumi dy lojtarë lejohen të ushtrojnë nën një kosh, por në asnjë moment të stërvitjes ata/ato nuk duhet të qëndrojnë më afër se 2 metra nga njëri-tjetri;**
- Nëse fusha i ka përshembull 4 kosha, atëherë lejohen deri në 8 lojtarë të ushtrojnë në të njëjtën kohë;**
- Distanca midis lojtarëve dhe trajnerëve duhet të jetë së paku 2 metra;**

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- **Secili lojtarë duhet të përdor vetëm 1 top të tij ose të saj që e ka sjell nga shtëpia;**
- **Lejohen vetëm ushtrime që nuk kanë të bëjnë me ndërrimin e topave dhe rekuizitave të tjera të cilat mund ti mbajnë lojtarët;**
- **Vetëm trajneri mund ti mbajë pajisjet sportive (konat, pengesat etj);**
- **Nuk këshillohet që të përzihen veshjet e lojtarëve apo gjërat personale të njëri-tjetrit;**
- **Socializimi dhe qëndrimi në fushë pas përfundimit të seancës stërvitore nuk rekomandohet;**

Këto udhëzime mbeten në fuqi deri në njoftimin e radhës nga institucionet e vendit tonë dhe Federata e Basketbollit të Kosovës.

Për fund mund të themi se karakteristikat e virusit COVID-19 nuk janë plotësisht të kuptueshme dhe për këtë arsye është e mundur që cdo fazë të planifikuar nga Qeveria kufizimet të futen përsëri në agjendë. Kjo është arsyeja që ne duhet të vazhdojmë të jemi të disiplinuar dhe të kemi kujdes të madh.

Sinqerisht,

Arben FETAHU

Kryetar, FBK

Elvira DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme, FBK

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

